



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2023

LËNDA: Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan

Drejtuar: "**InfoSoft Office**" sh.p.k me adresë: Autostrada Tirane-Durres, km 8, Kashar, 1051 Tirane, Shqiperi.

Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar - Marrëveshje Kuader.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kancelari dhe bojera per Bashkine ,Agjencine Pyjore, SHMZSH dhe Gjendjen Civile”- Marrëveshje Kuadër - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, me fond limit **8,379,488** (tetëmilion e treqind e shtatëdhjetë e nëntëmijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) **lekë pa t.v.sh.**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-51390-11-25-2022

Publikime të mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomkisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. “InfoSoft Office” sh.p.k me Nipt: J62426002Q

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **6.071.195** (gjashtëmilion e shtatëdhjetë e njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë** (pa tvsh).

2. “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k me Nipt: J72124001N

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **6.400.048** (gjashtëmilion e katërqindmijë e dyzet e tetë) **lekë** (pa tvsh).

3. “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k me Nipt: L91418502J

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **7.777.234** (shtatëmilion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatëmijë e dyqind e tridhjetë e katër) **lekë** (pa tvsh).

4. “ARTAN LLOZANA” sh.p.k me Nipt: K32731239W

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **8.343.358,5** (tetëmilion e treqind e dyzetë e tremijë e treqind e pesëdhjetë e tetë presje pesë) **lekë** (pa tvsh).

5. “COLOMBO” sh.p.k me Nipt: K36608208V

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **7.494.759** (shtatëmilion e katërqind e nëntëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) **lekë** (pa tvsh).

6. “Adenis Kastrati Kastrati” sh.p.k me Nipt: L51611004I

Vlera e paraqitur në këtë procedurë është **0** (zero) **lekë** (pa tvsh).

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Adenis Kastrati Kastrati” sh.p.k me Nipt: L51611004I

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur ofertë ekonomike si dhe asnjë dokument ligjor, teknik dhe ekonomik – financiar.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

2.“COLOMBO” sh.p.k me Nipt: K36608208V

Operatori ekonomik ka paraqitur formularin e ofertes ku ofron çmimin prej 7,330,000 (shtatëmilion e treqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh.

KVO bëri verifikimin e ofertës nëse ka apo jo gabime aritmetike. Nga verifikimi rezultoi se oferta kishte gabime aritmetike dhe shumat absolute të të gjitha korigjimeve ishin në vlerën prej 164,759 (njëqind e gjashtëdhjetë e katërmijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë, vlerë e cila është më e madhe se 2 % e vlerës ekonomike të ofruar.

Në pikën 3 të nenit 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" të VKM nr.285, dt.19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, përcaktohet se :

Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korigjohet në bazë të tij.

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korigjohet sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korigjohet.

Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur:

- shumat absolute të të gjitha korigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

Për sa mësipër, oferta konsiderohet e parregullt dhe refuzohet.

Oferta e operatorit ekonomik s'kualifikohet për arsyen e mësipërme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “**InfoSoft Office**” sh.p.k me Nipt: **J62426002Q** me adresë: Autostrada Tirane-Durres, km 8, Kashar, 1051 Tirane, Shqipëri, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **6.071.195** (gjashtëmilion e shtatëdhjetë e njëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të Procedurës:

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Drejtori i Përgjithshëm i ASHP

Edvin Palloshi